



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

Nr. 204 / Prot.  
12

Patos, më 13/02/2024

Lënda: Raporti vjetor i veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024

**MINISTRISË SË FINANCAVE**  
**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË**  
**BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK**  
**DREJTORISSË SË HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**  
Bulevardi “ Dëshmorët e Kombit”, nr.3, Tiranë

Në vijim suajës me nr. 675 prot., datë 16.01.2025, protokolluar pranë bashkisë Patos me nr. 204 prot., datë 20.01.2025, bashkëlidhur po ju dërgojmë një kopje të Raportit Vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024, së bashku me pasqyrat përkatëse.



**KRYETARI**  
**Fatjon Duro**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

Nr. 204 / Prot.

1

Patos, më 13.10.2025

**RAPORTI VJETOR**  
**I NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**  
**PËR VITIN 2024**

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	Përmbledhja ekzekutive.....	3
II.	Baza ligjore.....	4
III.	Organizmi i njësisë së auditimit të brendshëm.....	4
IV.	Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm .....	4
	a) Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese.....	4
	b) Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve.....	5
	c) Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.....	5
	d) Gjetjet kryesore sipas sistemeve .....	6
	e) Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.....	6
V.	Rekomandimet.....	9
VI.	Monitorimi i sistemit dhe sigurimit i cilësisë .....	10
VII.	Analiza e kapaciteteve audituese .....	10
VIII.	Konkluzion.....	12
	a) Konkluzione mbi problematikën e punës audituese .....	12
	b) Prioritetet për vitin e ardhshëm.....	12

## **I. Përmbledhja ekzekutive**

Raporti vjetor mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm pranë bashkisë Patos paraqet rezultatet e arritura për vitin 2024, problemet e identifikuara dhe rekomandimet për përmirësime.

Në raport jepet një pasqyrë e hollësishme e veprimtarisë së NJAB, duke analizuar rezultatet e arritura në përmbushjen e objektivave të parashikuara në planin vjetor. Në këtë dokument pasqyrohen probleme e çështje të sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit, të menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes të subjekteve të audituara gjatë periudhës.

Auditi i Brendshëm si veprimtari e pavarur ka synuar mbështetjen e menaxhimit të subjektit publik (bashkia Patos) për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim si dhe duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Patos për periudhën 1 Janar 2024 deri më 31 Dhjetor 2024 ka ushtruar veprimtarinë audituese në përputhje me planin e auditimit për vitin 2024 të miratuar me nr.2507/2 prot., datë 10.10.2023, i ndryshuar me nr.2507/5 prot., datë 02.02.2024 si dhe në zbatim të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar.

Për vitin 2024 ishin planifikuar për tu realizuar 11 angazhime auditimi, të cilat janë realizuar të gjitha në përputhje me planin vjetor.

Auditimit e realizuara për vitin 2024 janë si më poshtë:

1. Drejtoria e Integritimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sportit
2. Zbatim i rekomandimeve të auditimit të brendshëm
3. Sektori i emergjencave civile dhe strehimit
4. Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor
5. Sektori i Prokurimeve Publike
6. Sektori i Planifikimit Urban
7. Qendra Kulturore e Fëmijëve dhe kopshti nr.1
8. Drejtoria e Financës
9. Agjencia e Shërbimeve Publike
10. Sektori i zyrës me një ndalesë
11. Drejtoria e të Ardhurave vendore

Nga auditimet e kryera gjatë vitit 2024 janë lënë në total 33 rekomandime nga të cilat:

- 8 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm
- 12 rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor
- 6 rekomandime të karakterit organizativ
- 1 rekomandim për arkëtim
- 6 rekomandime të tjera



## II. Baza ligjore

Gjatë vitit 2024 veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm është mbështetur në:

### a) *Kuadri kombëtar i auditimit të brendshëm*

- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me ligjin nr. 12, datë 02.02.2023
- Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik:
- Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 86, datë 25.10.2016 “Për miratimin e kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik”

### b) *Kuadri ndërkombëtar*

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm
- Praktikrat profesionale të publikuara nga IIA

### c) *Kuadri ligjor për njësitë e qeverisjes vendore*

## III. Organizmi i njësisë së auditimit të brendshëm

**Misioni i NJAB** në bashkinë Patos është të përmirësoj veprimtarinë e institucionit duke vlerësuar dhe ofruar siguri të arsyeshme për menaxhimin e burimeve, përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin të riskut si dhe të ofrojë këshillim për menaxhimin i projektuar për të shtuar vlerë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Patos është e organizuar në nivel sektori sipas VKB nr.75, datë 30.11.2023 e përbërë nga përgjegjësi i njësisë dhe dy specialistë. Në zbatim të ligjit nr. 114/2014 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” NJAB raporton direkt dhe është në varësi të kryetarit të bashkisë.

## IV. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

### a) *Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese*

Plani vjetor i auditimeve për vitin 2024 është miratuar me vendimin nr. 2507/2 prot., datë 10.10.2023 dhe është ndryshuar me nr. 2507/5 prot., datë 02.02.2024.

Në planin vjetor ishin planifikuar të realizoheshin 11 angazhime auditimi të cilat janë realizuar në masën 100 %.

Subjektet e audituara gjatë vitit 2024 paraqiten si më poshtë:

1. Drejtoria e Integritit European, Arsimit, Kulturës dhe Sportit
2. Zbatim i rekomandimeve të auditimit të brendshëm
3. Sektori i emergjencave civile dhe strehimit
4. Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor
5. Sektori i Prokurimeve Publike
6. Sektori i Planifikimit Urban
7. Qendra Kulturore e Fëmijëve dhe kopshti nr.1
8. Drejtoria e Financës
9. Agjencia e Shërbimeve Publike
10. Sektori i zyrës me një ndalesë
11. Drejtoria e të Ardhurave vendore

Për realizimin e auditimeve të mësipërme nuk janë realizuar devijime nga plani vjetor.

**b) Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve**

Misionet e auditimit për vitin 2024 janë realizuar në përputhje me planin vjetor sipas tabelës më poshtë

Nr	Subjekti	Lloji i auditimit
1	Drejtoria e Integritimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sportit	Performance
2	Zbatim i rekomandimeve të auditimit të brendshëm	Përputhshmërie
3	Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit	Përputhshmërie
4	Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor	Përputhshmërie
5	Sektori i Prokurimeve Publike	Përputhshmërie
6	Sektori i Planifikimit Urban	Përputhshmërie
7	Q.K.F dhe kopshti nr. 1	Përputhshmërie
8	Drejtoria e Financës	<b>Kombinuar</b>
9	Agjencia e Shërbimit Publik	<b>Kombinuar</b>
10	Sektori i zyrës me një ndalesë	Përputhshmërie
11	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	Përputhshmërie

*Gjatë vitit 2024 NJAB ka përfshirë detyrimet e prapambetura si drejtim auditimi në auditimin e drejtorisë së Financës ku u konstatua se: Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit buxhetor formon stokun e detyrimeve të prapambetura. Gjendja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 1,190,709 lekë për 9 subjekte e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve të cilat janë brenda afatit 60 ditor të likuidimit të detyrimeve në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 21.05.2022.*

**c) Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre**

Në planet Strategjike dhe Vjetore janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e bashkisë.

Për vlerësimin e risqeve është vepruar në bazë të metodologjisë së përcaktuar në ligjin për auditimin e brendshëm dhe manualin e procedurave të auditimit.

Në bazë të risqeve të vlerësuara janë hartuar edhe programet e auditimit duke parashikuar shtrirje kohore të ndryshme, për fusha me risk të ndryshëm.

Faktoret e marrë parasysh në vlerësimin e riskut kanë qenë:

- Vlera dhe përdorimi i burimeve në dispozicion të subjektit të audituar;
- Zbatimi i ligjshmërisë, politikave, procedurave, rregulloreve e planeve;
- Arritja e objektivave dhe rezultateve të pritshme nga subjekti;
- Ruajtja dhe mirëadministrimi i aseteve, pronë e subjektit publik;
- Kërkesat e raportimit financiar;
- Mjedisi i kontrollit në subjekte;
- Raportet e mëparshme të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm



Bazuar në faktorët e përmendur NJAB ka vlerësuar me risk të lartë për vitin 2024 sistemet në vijim:

- ✓ Sistemi i prokurimeve
- ✓ Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar
- ✓ Sistemi i menaxhimit të riskut
- ✓ Sistemi i kontrollit të brendshëm
- ✓ Investimet

**d) Gjetjet kryesore sipas sistemeve**

Gjetjet e evidentuara nga auditimet e kryera gjatë vitit 2024 paraqiten si më poshtë:

**1. Drejtoria e Integritimit Europian, Arsimit, Kulturës dhe Sportit**

- 2 gjetje tek sistemi i pagesave
- 4 gjetje tek sistemi i kontrollit të brendshëm
- 2 gjetje të tjera

**2. Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit**

- 2 gjetje tek sistemi i përputhshmërisë me bazën ligjore
- 2 gjetje të tjera

**3. Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor**

- 1 gjetje tek sistemi i taksave
- 1 gjetje tek sistemi i kontrollit të brendshëm

**4. Sektori i Prokurimeve**

- 3 gjetje tek sistemi i prokurimeve dhe blerjeve

**5. Sektori i Planifikimit Urban**

- 1 gjetje tek sistemi i administrimit, pronës dhe pasurisë

**6. Qendra kulturore e fëmijëve dhe kopshti nr.1**

- 2 gjetje tek sistemi i kontrollit të brendshëm
- 1 gjetje tek sistemi i përputhshmërisë me bazën ligjore
- 2 gjetje tek sistemi organizativ

**7. Agjencia e Shërbimeve Publike**

- 1 gjetje tek sistemi i prokurimeve publike
- 1 gjetje tek sistemi i pagesave
- 1 gjetje tek sistemi i kontrollit të brendshëm
- 1 gjetje tek të tjerat

**8. Sektori i zyrës me një ndalesë**

- 2 gjetje tek sistemi i transparencës dhe konsultimit publik

**9. Drejtoria e të Ardhurave Vendore**

- 3 gjetje tek sistemi i taksave dhe tarifave vendore
- 1 gjetje tek sistemi i kontrollit të brendshëm

**e) Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm**

Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për bashkinë Patos është kryer sipas komponentëve të kontrollit të brendshëm dhe sipas gjetjeve gjatë angazhimeve të auditimit të brendshëm.

Konrolli i brendshëm zbatohet ndërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri tjetrin:

## 1. Mjedisi i kontrollit:

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

### a. Integriteti dhe vlerat etike:

-Me Vendimin sipas shkresës nr. 52 prot., datë 07.01.2020, është miratuar Kodi i Sjelljes për bashkinë Patos në të cilën janë të përfshirë rregulla të etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Për vitin 2024 është miratuar Rregullore e brendshme e bashkisë me vendimin nr. 25, datë 26.01.2024 të Kryetarit të bashkisë.

-Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë bashkisë, ato regjistrohen pranë Zyrës me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe realizohet kthimi i përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore".

-Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë" si dhe ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin e punonjësve të saj 6 mujor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.

### b. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje:

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë.

-Çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale e protokoll.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.

-Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së institucionit.



**c. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë:**

Me vendimin nr. 25, datë 26.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së bashkisë Patos dhe njësisë administrative.

-Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA janë miratuar objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Struktura organizative e miratuar me VKB nr.75, datë 30.11.2023 është në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë .

**d. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave:**

Nëpunësit e Bashkisë Patos i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist në përputhje me ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij. Punonjësit administrativ dhe të terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

**e. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale:**

Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2024 është ngritur me urdhërin nr. 7, datë 06.01.2024. Nga GMS janë hartuar procesverbalet përkatëse për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma "b", neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për MFK i miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

**2. Menaxhimi i riskut**

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen. mekanizmat e regjistrit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut. Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut me vendimin nr.2550 prot., date 29.09.202. Në zbatim të strategjisë është hartuar dhe miratuar Regjistri i Riskut në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike", Aneksi 2, "Regjistri dhe matrica e riskut" si dhe Manualin për MFK i miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, "Menaxhimi i riskut". Gjithashtu është hartuar regjistri i riskut me nr. 3444 prot., date 12.09.2024 i përditësuar sipas ndryshimeve të struktures së institucionit

**3. Aktivitet e kontrollit**

Bashkia Patos ka ngritur grupin e punës për hartimin e gjurmëve të auditimit sipas urdhërit nr. 215, datë 01.12.2023. Aktualisht janë hartuar gjurmë auditimi për NJAB, prokurimet publike, shërbimin social, integrimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore.

Bashkia nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit për të gjitha proceset e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

#### 4. Monitorimi

Bashkia Patos ka hartuar dhe dërguar pranë MF, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Raporti Vjetor për Funksonimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe PyetëSORIN e Vetëvlerësimit për Komponentët e MFK të Brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit" i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike", pika 15 dhe Manualin për MFK, miratuar me Urdhrin e MF nr. 108, datë 17.11.2016 Kapitulli III, pika 3.5 "Monitorimi dhe raportimi.

#### 5. Informimi dhe komunikimi

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Patos dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkreSORE dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

#### 6. Vlerësimi sipas raporteve të AB

Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm është audituar edhe nga NJAB në angazhimet e realizuara për vitin 2024 ku ka konstatuar disa mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke lënë dhe rekomandimet përkatëse.

**Për vitin 2024 sistemi i kontrollit të brendshëm efektivisht mirë, por ka nevojë për disa përmirësime të sistemeve dhe procedurave**

E verdhë



#### V. Rekomandimet

##### a) Rekomandimet e propozuara

Në përfundim të auditimeve të realizuara gjatë vitit 2024 NJAB ka lënë rekomandime për çdo subjekt në bazë të gjetjeve të identifikuara. Rekomandimet e lëna paraqiten si më poshtë:

1. Drejtoria e Integritit European, Arsimit, Kulturës dhe Sportit: 3 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe 3 rekomandime të karakterit organizativ dhe 2 rekomandime të tjera



2. Sektori i Emergjencave Civile: 2 rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, 1 rekomandim i karakterit organizativ dhe 1 rekomandim i natyrës tjetër
3. Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor: 1 rekomandim për arkëtim dhe 1 rekomandim për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm
4. Sektori i Prokurimeve Publike: 3 rekomandime për përmirësim të kuadrit ligjor
5. Sektori i Planifikimit Urban: 1 rekomandim i karakterit tjetër
6. Qendra kulturore e fëmijëve dhe kopshti nr. 1: 2 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe 1 rekomandim për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe 1 rekomandim me karakter organizativ
7. Agjencia e Shërbimeve Publike: 1 rekomandim për përmirësimin e kontrollit të brendshëm, 2 rekomandime për përmirësim të kuadrit ligjor dhe 1 rekomandim i natyrës tjetër
8. Sektori i zyrës me një ndalesë: 2 rekomandime për rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor.
9. Drejtoria e të Ardhurave Vendore: 1 rekomandim për sistemin e kontrollit të brendshëm, 2 rekomandime për përmirësim të kuadrit ligjor dhe 1 rekomandim i natyrës tjetër.

#### **b) Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit**

Të gjitha reagimet e lëna janë pranuar nga subjektet përkatëse dhe është dërguar plani i veprimit pranë Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Disa rekomandime janë zbatuar dhe pjesa tjetër janë në proces zbatimi.

#### **VI. Monitorimi i sistemit dhe sigurimit i cilësisë**

NJAB ka miratuar programin e sigurimit të cilësisë i cili është miratuar me shkresën nr. 2033 prot., datë 28.07.2023. Bazuar në Manualin e auditimit të brendshëm sigurimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm i cili fillon gjatë gjithë fazës së angazhimit të auditimit dhe vazhdon me përfundimin e tij dhe përpilimin e çdo dosje auditimi sipas kërkesave ligjore në fuqi.

#### **VII. Analiza e kapaciteteve audituese**

##### **a) Problemet e konstatuara në lidhje me funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.**

Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Patos është e organizuar në nivel sektori sipas VKB nr. 75, datë 30.11.2023 e përbërë nga përgjegjësi i njësisë dhe dy specialistë. Në zbatim të ligjit nr. 114/2014 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” NJAB raporton direkt dhe është në varësi të kryetarit të bashkisë. NJAB e ka të vështirë të funksionoj sipas manualit të auditimit të brendshëm për shkak të vakancave të vazhdueshme në Sektorin e AB.

##### **b) Kapacitetet audituese**

Aktualisht NJAB përbëhet nga përgjegjëse e sektorit Ernesta Hamiti dhe 2 specialiste Rajmonda Vela dhe Romina Balla.

1. Ernesta Hamiti ka përfunduar Master Profesional në Kontabilitet dhe auditim pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe Master i Shkencave në Banka dhe Tregje Financiare pranë Universitetit Mesdhetar. Ka 8 vite eksperiencë punë në fusha të ndryshme dhe 3.5 vite në auditim. Ka përfunduar procesin e



certifikimit si audituese e brendshme pranë Ministrisë së Financave në Korrik 2023.

2. Romina Balla ka përfunduar Master Profesional në Ekonomiks pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ka 5 vite eksperiencë pune në fusha të ndryshme dhe 8 muaj në auditim. Është e pacertifikuar.
3. Rajmonda Vela ka përfunduar studimet në Ekonomiks pranë Universitetit të Vlorës. Ka 30 vite eksperiencë punë dhe 1 vit në auditim. Është e pacertifikuar.
- Romina Balla ka qenë me leje lindje për periudhën Shkurt – Dhjetor 2024. Deri në 1 nëntor 2024 pjesë e NJAB ka qenë Xhevahire Gjoka e cila ka përfunduar studimet në Ekonomi dhe Politika Agrare pranë Universitetit Bujqësor dhe ka 20 vite eksperiencë pune. Është e pacertifikuar.

**c) Zhvillimi aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve**

Trajnimet e kryera nga stafi i NJAB, bashkia Patos paraqiten në tabelën më poshtë:

Audituesi	Tema	Data e Zhvillimit	Orë	Organizuar nga
<b>Ernesta Hamiti</b>				
	Standardet e reja të auditimit	2 Dhjetor 2024	8 orë	Ministria e Financave
	Planifikimi dhe vlerësimi i riskut	3 Dhjetor 2024	8 orë	Ministria e Financave
	Auditimi i Performancës	4 Dhjetor 2024	8 orë	Ministria e Financave
	Auditim i Pasqyrave Financiare	10,12 dhe 13 Dhjetor 2024	24 orë	Projekti Financat Lokale
	Taksat vendore dhe apelimi tatimor	08 Tetor 2024	8 orë	Projekti Financat Lokale
	Prokurimi me vlerë të vogël	6 Shtator 2024	3 orë	ASPA (online)
	Auditimi i Performancës	06 – 20 Maj 2024	12 orë	ASPA (online)
	Auditimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm	Tetor 2024	12 orë	ASPA (online)
<b>Xhevahire Gjoka</b>				
	Prokurimi me vlerë të vogël	6 Shtator 2024	3 orë	ASPA (online)
	Auditimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm	Tetor 2024	12 orë	ASPA (online)
<b>Romina Balla</b>				
	Auditimi i Performancës	06 – 20 Maj 2024	12 orë	ASPA (online)
<b>Rajmonda Vela</b>				
	Auditim i Pasqyrave Financiare	10,12 dhe 13 Dhjetor 2024	24 orë	Projekti Financat Lokale

## VIII. Konkluzione

### a) Konkluzione mbi problematikën e punës audituese

Gjetjet e rezultuara nga angazhimet e auditimit, për subjektet (drejtoritë e audituara zhvillimin e veprimtarisë jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe rregulloret e miratuara )kanë ardhur nga mos funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, si rrjedhojë e mungesës së aftësive profesionale dhe përditësimit të vazhdueshëm të njohurive të punonjësve dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre, kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim menaxhimin e riskut, arritjen e objektivave, përmirësimin e performancës dhe veprimtarisë në përgjithësi.

Gjatë vitit 2024, nga ana e titullarit të Bashkisë ka patur një vlerësim në rritje për auditimin e brendshëm, duke u ndërgjegjësuar se kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm është jo vetëm një detyrim ligjor, por mbi të gjitha i shton vlerë subjektit të audituar.

Për subjektet e audituara dhe drejtuesit e tyre, procedurat e menaxhimit të riskut dhe marrjes se masave, duke vendosur kontrole dhe duke bërë efektive kontrollet ekzistuese, si përgjigje ndaj tij, por pavarësisht kësaj, mbeten akoma çeshtje të reja, të cilat kerkojnë përqëndrimin e vemendjes së auditimit të brendshëm, sic janë konkretisht auditimi i fondeve të buxhetit të shtetit të vena në dispozicion të njësive vendore dhe që kanë të bëjnë me trajtimin e shtresës në nevojë të popullsisë, auditimin e prokurimeve me vlera të larta dhe me vlerë të vogël, auditimin e procedurave që kanë të bëjnë me rekrutimin e burimeve njerëzore auditimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit etj.

### b) Prioritetet për vitin e ardhshëm

- Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm
- Kryerja e auditimeve në sistemet kryesore dhe me risk të lartë
- Rritja e cilësisë së punës së audituesve për dhënien e rezultateve të cilat shtojnë vlerë
- Zhvillimi profesional i audituesve
- Vlerësimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve
- Realizimi i auditimeve të këshillimit

**Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm**

**Ernesta Hamiti**



INSTITUCIONI Bashkia Patos  
NIVELI I ORGANIZIMIT TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM Sektor  
VARËSIA E NJËSISË SË AUDITIMIT BRENDSHËM Titullari i Institucionit  
NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË 3

Pasqyra 1

Të dhëna për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm për vitin 2024

NR	EMËR MBIEMËR	Pozicioni	Arsimi Bazë	Niveli i Diplomës	Eksperienca e Puntës		Zhvillimi Profesional				
					Vitet e Puntës Gjithsej	Vitet e Puntës në AB	Certifikimi		Trajtime në fushën e AB	Publikime në fushën e AB	
							1 pa certifikuar	Në proces certifikimi			1 certifikuar në vitin
a.	b.	1	2	3	4	5	6.1	6.2	6.3	7.1	7.2
1	Ernesta Hamiti	Përgjegjëse	Financë dhe Kontabiliteti	Master Shkencor	8	3.5			2023	83 orë	
2	Romina Balla	Specialiste	Ekonomiks	Master Profesional	5	0.6	+			12 orë	
3	Rajmonda Vela	Specialiste	Memaxhim biznes	Master Shkencor	30	1	+			24 orë	
4	Xhevalire Gjoka	Specialiste deri në 1.11.2024	Ekonomi Agrare	4 vjecare	20	1	+			15 orë	

Drejtuuesi i NjAB  
Ernesta Hamiti

Adresa: Lagja "Nafetar", Kruga "Unaza", Patos



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË PATOS

Pasqyrja 2

Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2024

Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Gjithsej	Realizimi i angazhimeve të auditimit							Në numër	
			Auditime të realizuara sipas llojit të tyre							Statusi i Angazhimit	
			Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Kësbillimi		Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces				
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)	3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2
1	Drejtoria e Integritimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sportit	1		1						1	
2	Zbatim i rekomandimeve të auditimit të brendshëm	1	1							1	
3	Spektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit	1	1							1	
4	Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor	1	1							1	
5	Spektori i Prokurimeve	1	1							1	

	Publike																		
6	Sektori i Planifikimit Urban	1	1																1
7	Q.K.F dhe kopshti nr. 1	1	1																1
8	Drejtoria e Financës	1							1										1
9	Ajencia e Shërbimit Publik	1							1										1
10	Sektori i zyrës me një ndalesë	1	1																1
11	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	1	1																1
	<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>1</b>					<b>2</b>										<b>11</b>

**Drejtuesi i NJAB**  
**Ernesta Hamiti**



**NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË PATOS**

**Pasqyra 3**

**Përmbledhëse e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit për vitin 2024**

**000/lekë**

Nr.	Subjekti të Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMIT										Shuma e dëmit ekonomik
		2.1	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.1	
a.	1	Prokurim, blerje & investime	Paga, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig.shoq, sig.shëndetësore, përkuqdesje shoqërore	Tatime, taksa, dogana	Administrim prone, pasurie	Privatizime, shitje, qiradhënie	Kontrolli i brendshem	Legalizime, Urbanistikë, kthim pronash	Kreditim, subvencione	Të tjera	3
1	Drejtoria e Integritimit Europian, Arsimit, Kulturës dhe Sportit	2.1	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.1	59,5
2	Zbatim i rekomandimeve të auditimit të brendshëm											0
3	Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit											0
4	Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor											0



a.	1	2.1	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.1	3
5	Sektori i Prokurimeve Publike											0
6	Sektori i Planifikimit Urban											0
7	Q.K.F dhe kopshti nr. 1											0
8	Drejtoria e Financës											0
9	Agjencia e Shërbimit Publik											0
10	Sektori i zyrës me një ndalesë											0
11	Drejtoria e të Ardhurave Vendore											0

**Drejtuessi i NJAB**  
**Ernesta Hamiti**

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË PATOS

Pasqyra 4

Përmbledhëse e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve për vitin 2024

Në numër

Nr.	Subjekti i Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE										Gjithsej	
		prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime,	Fondet e sig.shoq, sig. shëndetësore, përkujdesje	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemi i kontrollit të brendshëm	legalizimeve, Urbanistikës,	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera		
a.	1	2.1	2	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.1	3
1	Drejtoria e Integrimit Europian, Arsimit, Kulturës dhe Sportit								4			2	8
2	Zbatim i rekomandimeve të auditimit të brendshëm												
3	Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit					1						3	4
4	Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor				1				1				2
5	Sektori i Prokurimeve Publike	3											3
6	Sektori i Planifikimit Urban					1							1
7	Q.K.F dhe kopshti nr. 1								2				5
8	Drejtoria e Financës												-

9	Agjencia e Sherbimit Publik	1	1											1		4
10	Sektorit i zyrës me një ndalesë														2	2
11	Drejtoria e të Ardhurave Vendore					2								1		4
<b>Totali</b>		4	3	0	3	1	1	1	9	0	0	0	12			33

Drejtuuesi i NJAB  
Ernesta Hamiti





# NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHIKINË PATOS

Pasqyrja 5

Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2024

në numër

Nr	Rekomandimet e dhëna sipas prioritetit	Subjekte të Audituarra	Statusi i Rek. të dhëna në vitin e mëparshëm	STATISTI I REKOMANDIMEVE				
				Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar nga menaxhimi	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Arsyetja e mos zbatimit
<b>a.</b>	<b>1</b>			<b>4.1</b>	<b>4.2</b>	<b>4.3</b>	<b>4.4</b>	<b>4.5</b>
<b>I</b>	<b>Rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm</b>			3	3	3		
1	Drejtoria e Integritimit, Arsimit, Kulturës dhe Sportit			1	1		1	
2	Drejtoria e Zhvillimit Buqësor			2	2	1	1	
3	Qendra Kulturore e Rrethit dhe Kopshti nr.1			1	1		1	
4	Ajencia e shërbimit publik			1	1			
5	Drejtoria e të Ardhurave Vendore							
<b>I</b>	<b>Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor</b>							
1	Sektori i emergjencave civile			2	2	1	1	
2	Sektori i Prokurimeve publike			3	3	1	2	
3	Qendra Kulturore e Rrethit dhe Kopshti nr.1			1	1		1	
4	Ajencia e shërbimeve publike			2	2		2	
5	Sektori i zyrës me një ndalesë			2	2			
6	Drejtoria e të Ardhurave Vendore			2	2			
	<b>SHTIMTA 1</b>			<b>20</b>	<b>20</b>		<b>6</b>	<b>11</b>
<b>II</b>	<b>Rekomandime të karakterit organizativ</b>							<b>3</b>

1	Drejtoria e Integrimit, Arsimit, Kulturës dhe Sportit			3	3	2	1	
2	Qendra Kulturorë e Fëmijëve dhe Kopshit nr 1			2	2		2	
3	Sektori i emergjencave civile			1	1	1		
	<b>SHUMUA 2</b>			<b>6</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>0</b>
	<b>III</b>	<b>Rekomandime për arkatime</b>						
1	Drejtoria e Zhvillimit Buqësor			1	1		1	
	<b>SHUMUA 3</b>			<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
	<b>IV</b>	<b>Rekomandime të tjera</b>						
1	Drejtoria e Integrimit, Arsimit, Kulturës dhe Sportit			2	2	2		
2	Sektori i emergjencave civile			1	1	1		
3	Sektori i Planifikimit Urban			1	1			
4	Ajencia e shërbimeve publike			1	1		1	
5	Drejtoria e të Ardhurave Vendore			1	1			
	<b>SHUMUA 4</b>			<b>6</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>2</b>
	<b>TOTALI (SHUMUA 1+SHUMUA 2+SHUMUA 3+SHUMUA 4)</b>			<b>33</b>	<b>33</b>	<b>12</b>	<b>16</b>	<b>5</b>

Drejtuessi i NJAB  
Ernesta Hamiti

